

BULETIN



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

PRILL -QERSHOR 2005

Buletin 3-mujor /Nr. 12

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbeshtetjen financiare të CORDAID “CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT”

PASQYRA E PËRMBAJTJES

1. VËZHGIME

- 1.1 Respektimi I të drejtave të emigrantëve
- 1.2 Fushata zgjedhore dhe respektimi i të drejtave politike të qytetarëve

2. VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE OFRIM EKSPERTIZE

2.1 Veprimtari trajnuese

- 2.1.1 Trajnimi i vëzhguesve KSHH për monitorimin e zgjedhjeve parlamentare të 3 Korrikut 2005

2.2 Ofrim ekspertize

- 2.2.1 Seanca këshillimi ofruar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me reformat në burgje, parë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut
- 2.2.2 Ngritja e kapaciteteve të administratës së burgjeve

- 2.2.3 Takim pune lidhur me finalizimin e draftit të parë të Kodit të Sjelljes për administratën e burgjeve dhe çështje të tjera të rëndësishme

- 2.4 Takim pune me përfaqësues të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për politikë dhe punësim të të dënuarve në burgje

3. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

- 3.1 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendase dhe të huaja

- o Takim i z. Rupel me përfaqësues të partive politike dhe të shoqërisë civile, Tiranë, 11 maj 2005
- o Takim ballafaques i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të të njeriut në Shqipëri, Tiranë, më 19 prill 2005
- o Pjesëmarrje në Mbledhjen e grupit të punës të Konsorciumin Ndërkombëtar për reformën ligjore, penale dhe të drejtësisë, nënkomiteti për drejtësinë e të miturve
- o Takim me një grup austriakësh

4. PROJEKTE TË REJA

- a) Projekti “Çdo qytetar mund të kontribuojë për të ardhmen e vet”

5. PUBLIKIMET E KSHH-SË GJATË MUAJVE PRILL – QERSHOR 2005

- 5.1 Buletini informativ “Rikthim në shoqëri”
- 5.2 Promovimi i librit udhëzues për administratën e burgjeve “Drejtimi i burgut nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut”
- 5.3 Udhërrefyesi “Zgjedhësit në procesin zgjedhor”

6. TRYEZA DHE KONFERENCA

- 6.1 Konferencë për shtyp
- 6.2 Sesion prezantues për librin “Drejtimi i burgut nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut”
- 6.3 Tryezë e rrumbullakët “Respektimin e të drejtave të personave të paraburgosur - disa çështje të ligjit dhe praktikës”

7. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

8. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË

- a) Ankesat e qytetarëve
- b) Raste të verifikuara

9. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHTETËRORE DHE ORGANIZATA

10. KSHH DHE MEDIA

10.1 Suplemente

10.2 Pasqyrimi I aktiviteteve të KSHH-së në media

10.3 Emisione në TV

- 10.3.1 Pjesëmarrje në programin e “Mirëmengjes” të Radio Televizionit Shqiptar, Tiranë, më 16 Prill 2005
- 10.3.2 Pjesëmarrje në programin e Radio Tiranës, kanali 1 dhe 2 dhe të radio Tiranës në Satelit për shqiptarët jashtë Atdheut, Radio Tirana, Tiranë, më 17 prill 2005

11. NGRITJE KAPACITETESH TË VETË ORGANIZATËS

- 11.1 Vizita studimore në Kroaci
- 11.2 Trajnimi “Menaxhimi i projektit”
- 11.3 Trajnimi “Marëdhëniet publike”

**Rr: “Gjin Bue Shpata”, Pall. 5/1; Ap.4, Tiranë, Kutia postare Nr. 1752, Tel: 04 233671; 04229002
Fax: 04 233671; CEL: 068 20 23699; E-mail: office@ahc.org.al; ëeb-site: www.ahc.org.al**

1. VËZHGIME

1.1 Respektimi i të drejtave të emigrantëve¹

Në kuadër të festave, në pikat e kalim-kufirit me Greqinë ka patur një dyndje të emigrantëve shqiptarë. Gjatë muajit Maj 2005, korrespondentët e Korçës dhe Gjirokastrës realizuan misione vëzhgimi në pikat e kalim-kufirit Kakavijë dhe Kapshticë. Ata morën takime me komandantin e postës së kalim kufirit si dhe zhvilluan intervista kryesisht me emigrantë shqiptarë që ktheheshin nga policia greke për parregullsi të dokumentacionit, ose për shkak të kalimit të kufirit në mënyrë të paligjshme.

1.2 Fushata zgjedhore dhe respektimi i të drejtave politike të qytetarëve²

Gjatë muajit prill 2005, KSHH ndërmori një raund vëzhgimesh lidhur me shpalljen e listave paraprake, ndërsa gjatë muajit qershor 2005, ai u angazhua në vëzhgimin e fushatës zgjedhore në disa rrethe të vendit (Tiranë, Durrës, Pogradec, Kukës, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë). U vëzhguan: ngritja e KZZ-ve, trajnimi i anëtarëve të tyre, shpallja e listave përfundimtare, ngritja e qendrave të votimit dhe komisioneve të qendrave të votimit si dhe trajnimi i tyre, ngritja e grupeve të numërimit, trajnimi i tyre, etj.

3 VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE OFRIM EKSPERTIZE

2.1 Veprimtari trajnuese

2.1.1 Trajnimi i vëzhguesve KSHH për monitorimin e zgjedhjeve parlamentare të 3 Korrikut 2005

Me qëllim realizimin e një vëzhgimit profesional, objektiv dhe të pavarur të zgjedhjeve të 3 korrikut 2005, KSHH-ja trajnoi 116 vëzhgues afatgjatë (14 qershor 2005). Në këtë trajnim, veç problemeve lidhur me njohjen më të mirë të Kodit Zgjedhor, në mënyrë të veçantë u trajtuan çështje të tilla si: metodologjia e vëzhgimit, detyrat dhe të drejtat e vëzhguesve, qëndrimet dhe sjelljet e tyre, si edhe metodologjia e parashtrimit të vërejtjeve tek komisionet ku ata do të vëzhgonin. Vëzhguesit e trajnuan për monitorimin e procesit të votimit dhe të numërimit të votave.

Ky aktivitet pati një interes shumë të madh nga media e shkruar dhe elektronike, të cilat e mbuluan gjerësisht atë.

¹ Mundësuar nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit, projekti "Monitorimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga policia kufitare greke"

² Mundësuar nga projekti "Së bashku për një shoqëri demokratike ku respektohen të drejtat e njeriut" mbështetur financiarisht nga Fondacioni Soros, dhe projekti "Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri" mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

2.2 Ofrim ekspertize

2.2.1 Seanca këshillimi ofruar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me reformat në burgje, parë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut³

Në muajt prill dhe qershor 2005, eksperti hollandez Z. Jan van den Brand, i angazhuar pranë KSHH-së, me përvojë të gjatë në drejtimin e institucioneve penitenciare si edhe njohës i mirë i sistemit penenciar shqiptar zhvilloi dy seanca këshillimi me drejtues të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në njërin prej tyre mori pjesë Z. andi Muratej, specialist në Ministrinë e Drejtësisë.

Disa nga çështjet e trajtuara në këto seanca këshillimi ishin: organizmi i punësimit për të dënuarit, procedurat e inspektimit dhe instrumentat kryesore, procedurat dhe instrumentet për ngritjen e mekanizmit të ankesë-kërkesës së të dënuarve si edhe komitetet/bordet mbikëqyrëse në nivel qendror dhe të secilit burg, mënyra e organizimit dhe krijimi i mundësive të të dënuarve për të votuar, çështja e takimeve të kandidatëve për deputetë me të dënuarit në institucionet e riedukimit. Gjithashtu, u diskutua programi “Trajnimit të trajnerëve”.

Këto seanca këshillimore janë vlerësuar si të domosdoshme për DPSH-në dhe shumë efektive nga vetë drejtuesit e lartë të këtij institucioni.

2.2.2 Ngritja e kapaciteteve të administratës së burgjeve⁴

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të administratës së burgjeve, në muajin prill dhe qershor 2005, u zhvilluan dy sesione trajnimi (respektivisht sesioni 5 dhe 6 I realizuar në kuadër të këtij projekti).

Gjatë sesionit të pestë të punës, drejtues të burgjeve dhe ekspertët e huaj punuan për hartimin e një Kodi Kombëtar të Sjelljes për punonjësit e administratës së burgjeve dhe diskutuan rreth mundësive të zbatimit të tij në çdo institucion.. Pjesëmarrësit theksuan nevojën e hartimit të Kodit Sjelljes, i cili rregullon marrëdhëniet ndërmjet të dënuarve dhe stafit të administratës së burgjeve dhe marrëdhëniet e këtyre të fundit midis tyre.

Në këtë aktivitet, morën pjesë dhe ndihmuan me pjesëmarrjen e tyre drejtuesit dhe specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtorët e Institutit të Paraburgimit 313 dhe burgut 325 në Tiranë.

Z. Jan van den Brand, Drejtor dhe Koordinator i Marrëdhënieve me Jashtë në Agjencinë Kombëtare Hollandeze të institucioneve të Riedukimit si edhe ekspert i Këshillit të

³ Seancat këshillimore janë ofruar në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” dhe mbështeten financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

⁴ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

Europës për Europën Qendrore dhe Lindore. KSHH u përfaqësua nga znj. Edlira Papavangjeli, koordinatore programesh në KSHH.

Në datat 6-7 qershor 2005, KSHH-ja organizoi sesionin e gjashtë të punës me administratën e dy burgjeve pilot: të Rrogozhinës dhe të Peqinit. Në këtë aktivitet morën pjesë dhe kontribuan z. Engjëll Hysi, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, përfaqësues të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, drejtorët dhe stafi i nivelit të lartë i të dy burgjeve pilot. Z. Jan van den Brand, drejtor dhe koordinator i marrëdhënieve me jashtë në Agjencinë Kombëtare Holandeze të Institucioneve të Riedukimit dhe z. Theo Eesterout, drejtor rajonal në Holandë ofruan ekspertizën e tyre.

Tema kryesore e trajtuar ishte punësimi i të dënuarve, funksionet e punësimit në jetën e tyre, si mundësi për të siguruar respektin ndaj vetvetes, për t'i bërë ata të përgjegjshëm dhe të aftë, për rritjen e aftësive të tyre sociale si dhe për riintegrimin e tyre në shoqëri. U sollën përvoja të ndryshme për nxitjen e punësimit të të dënuarve. Kështu, mund të përdoret sistemi i privilegjeve ose kombinimi i aftësive të të dënuarve për të kryer punë të ndryshme me mundësitë e trajnimit profesional të tyre. Pjesëmarrësit diskutuan për mundësitë e organizimit të punësimit të të dënuarve dhe llojet e organizimit të tij në kushtet e sistemit të burgjeve shqiptare, sistemin e shpërblimit të tyre, mënyrën e rregullimit ligjor të punësimit të të dënuarve si edhe strukturat përgjegjëse shtetërore për të siguruar mundësitë e punësimit.

2.3 Takim pune lidhur me finalizimin e draftit të parë të Kodit të Sjelljes për administratën e burgjeve dhe çështje të tjera të rëndësishme⁵

Në 3 Maj 2005, u organizua një takim pune me Z. Engjëll Hysi, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve dhe përfaqësuesit e grupit të punës që punuan për hartimin e draftit të parë të Kodit të Sjelljes. Pjesë e diskutimit ishte projekt-ligji për shërbimin dhe kontrollin të brendshëm në sistemin e burgjeve. Përmes shëmbujve të shteteve të Europës Perëndimore, Lindore dhe Qendrore Z. Jan van den Brand prezantoi rrezikun potencial të shërbimeve të tilla dhe praktikën më të mirë në këtë fushë, duke theksuar se mekanizmi më i mirë për të parandaluar incidentet dhe për të luftuar korrupsionin dhe inkriminimin e stafit të burgjeve si edhe për të garantuar një trajtim human të personave të privuar nga liria është përmirësimi i bashkëpunimit të të gjithë aktorëve që veprojnë në sistemin e drejtësisë, gjithashtu edhe bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Informativ Shtetëror në Shqipëri dhe sistemit të burgjeve.

Në këtë mbledhje u diskutua dhe ra dakort mbi prioritetet, nevojat dhe kontributet e KSHH-së në vitin në vazhdim. Një vend të veçantë në këtë takim zuri diskutimi rreth Kodit Kombëtar të Sjelljes për administratën e burgjeve. Eksperti i ftuar ofroi komente rreth punës së bërë dhe paraqiti pranë Ministrisë së Drejtësisë përgëzimet e tij për punën e mirë lidhur me këtë dokument.

⁵ Ky aktivitet u krye në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

2.4 Takim pune me përfaqësues të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për politikave dhe punësimit të të dënuarve në burgje

Në datën 8 Qershor 2005, KSHH-ja organizoi një sesion një-ditor pune me drejtorët e institucioneve të paraburgimit dhe burgjeve në Tiranë si edhe me përfaqësues të lartë të departamentit të edukimit, të logjistikës dhe të trajtimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Qëllimi i tyre ishte diskutimi i politikave të punësimit të të dënuarve dhe trajtimin e tyre. Stafet e burgjeve pilot (Rrogzhinë dhe Peqin) parashtruan komentet, përfundimet dhe sugjerimet e tyre.

Përfaqësuesit e burgjeve dhe ekspertët e huaj pjesëmarrës në këtë sesion pune ndanë mendimin se hartimi I politikave të punësimit nga vetë administrata qendrore e burgjeve në bashkëpunim të ngushtë me personelin e çdo burgju, jo vetëm forcon respektin për punonjësit e bazës, por edhe lehtëson zbatimin e programeve të punësimit në praktikë.

3. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

3.1 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendase, të huaja dhe organizmat ndërkombëtarë

Takim i z. Rupel me përfaqësues të partive politike dhe të shoqërisë civile

Më datë 11 maj 2005, Dr. Dimitri Rupel, Kryetari i rradhës së OSBE-së organizoi takim me përfaqësues të partive politike dhe të shoqërisë civile. Në këtë takim u ftua edhe KSHH-ja.

Gjatë takimit u diskutua për zgjedhjet parlamentare 2005. Përfaqësues të KQZ-së, të Ministrisë së Pushtetit vendor dhe Decentralizimit bënë një tablo të shkurtër të masave të marra për përgatitje të procesit zgjedhor, të problemeve dhe të vështirësive të hasuara. Përfaqësues të partive politike, të pozitës, të opozitës dhe të LSI, ngritën shqetësime të ndryshme lidhur me procesin zgjedhor.

Takim ballafaques i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të të njeriut në Shqipëri, Tiranë, më 19 prill 2005

Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, pasi u njoh me raportet e publikuara nga Amnesty International, Departamenti Amerikan i Shtetit për të drejtat e njeriut dhe trafikun e lëndëve narkotike, organizoi një takim ballafaques për të trajtuar kritikën e adresuar ndaj institucioneve shqiptare. Në këtë takim, KSHH-ja u përfaqësua nga znj. Vasilika Hysi. KSHH-ja ka qënë aktive në vëzhgimin e një pjesë fushave të mbulura në këto raporte.

Organizatave pjesëmarrëse (Komiteti shqiptar i Helsinkit, GSHDNJ dhe QSHDNJ) kërkuan një rritje të rolit monitorues të Komisionit të Sigurisë Kombëtare për respektimin e të drejtave të personave të arrestuar dhe të dënuar, për përmirësimin e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore si dhe për vlerësimin e më të mirë të përfundimeve dhe rekomandimeve të organizatave vëzhguese vendase.

Pjesëmarrje në Mbledhjen e grupit të punës të Konsorciumin Ndërkombëtar për reformën ligjore, penale dhe të drejtësisë, nënkomiteti për drejtësinë e të miturve

Më 20 prill 2005, në zyrat e UNICEF –it u organizua Mbledhja e Konsorciumit ndërkombëtar për Drejtësinë e të Miturve. Qëllimi i takimi ishte përditësimi i informacionit për reformën ligjore në këtë fushë, trajnimet e Shkollës së Magjistratures për profesinistët që merren me drejtësinë e të Miturve, veprimtaritë OSBE-së dhe UNICEFit në këtë fushë.

Në këtë takim mori pjesë edhe KSHH-së, përfaqësuar nga znj Vasilika Hysi. KSHH-ja ka qënë mjaft aktive në bërjen e oponencës ligjore të legjislacionit për të mitur dhe ka qënë bashkëorganizatore (KSHH-ja, Ministria e Drejtësisë dhe UNICEF) e një tryeze për të diskutuar reformën në këtë fushë.

Përfaqësues të Komisionit të reformës ligjore informuan pjesëmarrësit se janë përgatitur propozimet për ndryshimet e nevojshme të Kodit penal dhe se brenda një periudhe të shkurtër do t'i paraqiten Këshillit të Ministrave.

KSHH-ja përshendet reformën e Ministrisë së Drejtësisë dhe respektimin e mendimeve të dhëna nga OJF-të dhe KSHH-ja dhe shpreson në vazhdimësinë e këtij procesi.

Takim me një grup austriakësh

Në datën 4 Qershor 2005, përfaqësues të KSHH-së pritën një grup përfaqësuesish të të drejtave të njeriut nga Austria. Qëllimi i vizitës ishte njohja e gjendjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri. Temat më të diskutuara ishin rreth ndarjes së pushteteve në Shqipëri, legjislacioni dhe procesi zgjedhor dhe respektimi i standarteve demokratike, etj.

4. PROJEKTE TË REJA

Projekti “Çdo qytetar mund të kontribuojë për të ardhmen e vet”

Gjatë periudhës prill- qershor 2005, KSHH-ja në bashkëpunim me Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (Soros) zbatoi projektin “Çdo qytetar mund të kontribuojë për të ardhmen e vet”. Qëllimi i këtij projekti ishte ofrimi i ekspertizës ligjore dhe profesionale në fushën e procesit zgjedhor me qëllim ndërgjegjësimin e opinionit publik lidhur me të drejtat e tyre kushtetuese në procesin zgjedhor, veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të projektit synonin ndërgjegjësimin e opinionit publik, njohjen e tij me ndryshimet e Kodit Zgjedhor, informimin për detyrimet ligjore që burojnë nga dispozitat e Kodit Zgjedhor për të gjitha instancat përgjegjëse duke filluar nga anëtarët e komisioneve zgjedhore, organet e qeverisjes vendore, rektorët e universiteteve, dekanët e fakulteteve deri tek zgjedhësit e thjeshtë.

5. PUBLIKIMET E KSHH-SË GJATË MUAJVE PRILL – QERSHOR 2005

5.1 Buletini informativ “Rikthim në shoqëri”

Duke filluar nga muaji prill 2005, KSHH-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve filloi botimin e buletinit informativ mujor të titulluar “Rikthim në shoqëri”. Ai u drejtohet të gjithë të dënuarve që vuajnë dënimin në burgjet shqiptare e administratës së këtyre institucioneve dhe opinionit publik. Qëllimi i botimit të këtij buletini është ndërgjegjësimi i të dënuarve me të drejtat e tyre, sidomos mbi disa çështje ligjore me interes për ta. Buletini përmban informacione rreth reformave që po pëson sistemi i burgjeve në Shqipëri dhe prezanton institucionet penitenciare tek opinionin publik shqiptar.

Buletini informativ “Rikthim në shoqëri” do të botohet dhe në muajt në vazhdim dhe mbështetet financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

5.2 Promovimi i librit udhëzues për administratën e burgjeve “Drejtimi i burgut nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut”⁶

KSHH përktheu në gjuhën shqipe librin “Drejtimi i burgut nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut”. Për ta prezantuar atë në publik, në datën 3 maj 2005 u organizua promovimi i tij. Ky libër është përkthyer në 12 gjuhë të tjera. Libri I shërben administratës së burgjeve. Ky libër është me interes edhe për një grup më të gjerë synues institucionet politikbërëse dhe ato vendimmarrëse, strukturat legjislative dhe ekzekutive që punojnë në fushën e burgjeve, OJF-të, studiuesit dhe studentët që janë të interesuar në këtë fushë. Ai do të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të administratës së burgjeve në fushën e drejtimit të burgjeve nga këndvështrimi i standarteve të të drejtave të njeriut.

Pjesëmarrës në këtë këtë aktivitet ishin përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Komisionit Mbikqyrës së Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Ministrinë e Drejtësisë, të Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve, Drejtorë të institucioneve të riedukimit, të Avokatit të Popullit, të Shkollës së Magjistraturës, OJF që punojnë në fushën e sistemit të burgjeve, organizma ndërkombëtarë të tilla si zyra e OSBE-së në Tiranë etj., anëtarë dhe vëzhgues të KSHH-së.

Z. Anastas Duro, Zëvendësministri i Drejtësisë, dhe Z. Engjëll Hysi, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, vlerësuan nismën e ndërmarrë nga KSHH-ja dhe falenderuan në mënyrë të veçantë mbështetjen financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit për të patur këtë libër në gjuhën shqipe. Më pas autori i librit Z. Andrew Coyle prezantoi librin udhëzues dhe mënyrën e përdorimit të tij nga ana e administratës së burgjeve.

5.3 Udhërrefyesi “Zgjedhësit në procesin zgjedhor”

Në kuadër të bashkëpunimit të KSHH-s me Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (Soros) për sensibilizimin e publikut, u përgatit një **udhërrëfyes “Zgjedhësit në procesin zgjedhor”** i hartuar në formë pyetje-përgjigjesh, në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë (shqip, greqisht dhe maqedonisht). Ky botim kishte si qëllim t’i vinte në ndihmë pakicave kombëtare që jetojnë në Shqipëri për të sqaruar në gjithë e

⁶ Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

tyre aspekte të veçanta të procesit zgjedhor. Ky udhërrëfyes është botuar në 6000 kopje dhe është shpërndarë në të gjithë rrethet e Shqipërisë, në fakultete si edhe në ato krahina ku jetojnë minoritetet greke dhe maqedonase nëpërmjet gazetës Panorama, korrespondentëve dhe aktivistëve të KSHH-së.

6. TRYEZA DHE KONFERENCA

6.1 Konferencë për shtyp⁷

Në datën 15 Qershor 2005, u organizua një konferencë për shtyp me rastin e publikimit të raportit të tretë për Shqipërinë përgatitur nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI). Ky raport paraqet gjendjen e respektimit të rekomandimeve të ECRI-it deri në datën 17 dhjetor 2004 lidhur me të drejtat e minoriteteve dhe grupeve të tjera, të emigrantëve të huaj dhe azil kërkuesve si dhe disa probleme të veçanta që kanë të bëjnë me trajtimin e minoritetit rom, komunitetit të egjiptianëve, pjesëmarrjes së tyre në jetën publike, politike dhe në sektorë të tjerë. Në këtë konferencë ishin të pranishëm një numër i konsiderueshëm i medias së shkruar dhe asaj elektronike të cilët shfaqën interes të veçantë mbi këtë raport.

6.2 Sesion prezantues i librit “Drejtimi i burgut nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut”⁸

Me qëllim prezantimin e librit dhe mënyrës së përdorimit të tij, **në 4 Maj 2005**, KSHH ftoi në një sesion të veçantë pune grupin kryesor synues që i drejtohet libri “Drejtimi i burgut nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut”, drejtorët dhe shefat institucioneve të riedukimit në Republikën e Shqipërisë si edhe nëpunësit më të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Z. Andrew Coyle, autori i këtij libri udhëzues i ofroi pjesëmarrësve zhvillimet e ardhshme ndërkombëtare në fushën e burgjeve në zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut. Në leksionin e tij⁹ ai u përqëndrua në dy probleme të rëndësishme: të drejtat e njeriut dhe drejtimi i burgut i cili u shoqërua nga një guidë praktike e mënyrës së zbatimit të tij në punën e përditshme të administratës së burgjeve. Ndërsa eksperti suedez Z. Per Colliander e përqëndroi vëmendjen e tij tek procedurat disiplinore dhe ndëshkimit, analizoi e ilustroi për pjesëmarrësit qëllimin e përdorimit në praktikë të këtij libri. Ky aktivitet pati interes dhe u mbulua gjerësisht nga media elektronike dhe ajo e shkruar.

6.3 Tryezë e rrumbullakët “Respektimin e të drejtave të personave të paraburgosur - disa çështje të ligjit dhe praktikës”

Në datën 14 Prill 2005, në ambjentet e Hotel Rogner, KSHH organizoi një tryezë pune për “Respektimin e të drejtave të personave të paraburgosur - disa çështje të ligjit dhe

⁷ Ky aktivitet u realizua me mbështetjen e CORDAID-it

⁸ Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

⁹ Leksioni i plotë i Z. Andreë Coyle është publikuar në faqen e internetit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

praktikës”¹⁰. Qëllimi i kësaj tryeze ishte adresimi i disa problemeve të dala nga zbatimi i Rregullores Nr. 1075, datë 15.09.1999 të Ministrisë së Rendit “Për sigurimin e trajtimin e të paraburgosurve” e cila vjen në kundërshtim me Ligjin Nr. 8328 datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, probleme të cilat shkaktojnë cënim të të drejtave të personave të paraburgosur.

KSHH kërkoi shfuqizimin e Rregullores Nr. 1075, datë 15.9.1999 të Ministrisë së Rendit Publik dhe zbatimin në vend të saj të Rregullores së Ministrisë së Drejtësisë. Me anë të kësaj tryeze KSHH tërhoqi vëmendjen se organet përkatëse shtetërore duhet të marrin masat e duhura për të siguruar respektimin e të drejtave të personave të paraburgosur dhe një trajtim të tyre në përputhje me ligjin Nr. 8328, datë 16. 4. 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Të ftuar në këtë tryezë ishin përfaqësues të lartë të Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, drejtues të institucioneve të paraburgimit të vëzhguara nga KSHH-ja si edhe vëzhgues të KSHH-së.

7. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT


Gjatë periudhës Prill-Qershor 2005, KSHH ka reaguar me 15 deklarata dhe komunikata për median të cilat adresuan probleme që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor dhe aspekte të ndryshme të tij, si: shpallja e listave të zgjedhësve, vonesat në krijimin e KZZ-ve, vonesat për grupet e numërimit të votave, të drejtën e ankimimit të zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhorë, etj. Gjithashtu KSHH ka nxjerrë njoftime të ndryshme për shtyp, si për publikimin e raportit të European Commission Against Racism (ECRI), mbi aktivitetet të ndryshme të realizuara nga KSHH-ja, etj.

8. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË

Ankesat e qytetarëve

Gjatë periudhës prill-qershor 2005 në adresë të KSHH-së kanë ardhur 54 letra dhe ankesa. Pjesa më e madhe ka patur si objekt vendime dhe procese jo të rregullta gjyqësore, dhunën e ushtruar nga ana e policisë, ankesa për shkeljen e të drejtave të emigrantëve në Greqi, etj. Gjithashtu nuk kanë munguar edhe ankesat për transferimet në institucione të tjera riedukimi. Në kuadër të këtyre ankesave, KSHH ka bashkëpunuar me OJF vendase si Shërbimi Ligjor Falas (TLAS), Fondacioni për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, si edhe dhe institucionet shtetërore si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e rendit Publik, Ministria e Drejtësisë, etj.

¹⁰ Kjo tryezë zhvillohet në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.



Raste të verifikuara

- Në datën **11 Prill 2005**, media bëri publike pretendimet e familjarëve të qytetarit Zef Prenga i cili mbahej në dhomat e paraburgimit të komisariatit të Mirditës pavarësisht se kishte kryer dënimin e dhënë nga gjykata. Meqenëse familjarët i ishin drejtuar Avokatit të Popullit, KSHH kontaktoi me këtë zyrë.
- Në datën **15 Prill 2005**, korrespondentja e KSHH-së e rrethit të Korçës kreu një vëzhgim në dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Koçës për të parë respektimin e të drejtave të personave të vendosur në kushtet e paraburgimit.
- Në datën **15 Prill 2005**, KSHH pas një sinjalizimi që pati nga media ndërmorri një verifikim në komisariatit e Fierit lidhur me kushtet e këtyre dhomave si edhe lidhur me mbajtjen në këtë paraburgim të 30 personave me vendim të formës së prerë, KSHH kontaktoi drejtpërdrejtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për ndjekjen e këtij rasti.
- Nga sinjalizime të marra, KSHH ka realizuar misione verifikimi të rasteve të keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë nga policia Greke. Korrespondenti I Vlorës ka realizuar takim me shtetasin CA I keqtrajtuar nga policia Greke. Lidhur me këtë rast korrespondentja e Korçës ka realizuar takime me drejtues të Komisarariatit në Bilisht, si edhe me drejtues të Prokurorisë pranë Gjatës së Rrethit Gjyqësor të Korçës.
- Gjatë muajit Qershor, pas ngjarjes së ndodhur në Institucionin e Riedukimit 302, Tiranë, ku disa të dënuar u helmuan, KSHH dërgoi vëzhgues në spitalin e burgut. KSHH realizoi takime më të dënuarit e shtruar në këtë institucion si edhe me punonjës të tjerë të këtij institucioni. KSHH-ja I dërgoi letër autoriteteve të burgut duke bërë rekomandimet përkatëse.

9. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHTETËRORE DHE ORGANIZATA

Gjatë këtij tre-mujore KSHH ka komunikuar vazhdimisht me institucionet shtetërore dhe organizatat vendase dhe të huaja. Ka patur 60 letra dalëse dhe 27 letra hyrëse. Kryesisht korrespondenca më e shpeshtë ka qenë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Ministrinë e Drejtësisë, Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, etj. Pjesa më e madhe e letrave të dërguara kanë qenë në kuadër të ankesave të ardhura në shtetas të ndryshëm për shkeljen e të drejtave të njeriut, si edhe në kuadër të aktiviteteve të ndryshme që ka organizuar KSHH.

Përgjithësisht, letrat e ardhura nga institucionet shtetërore, kanë qenë në përgjigje të letrave të KSHH-së. Vlen të përmendet korrektësia dhe përkushtimi në verifikimin e ankesave që KSHH u përcjell këtyre institucioneve dhe përgjigja e dhënë prej tyre. Në korrespondencën e hyrë nuk kanë munguar edhe ftesat për pjesëmarrje në aktivitete të organizuara nga këto institucione.

10. KSHH DHE MEDIA

10.1 Sensibilizimi dhe edukimi ligjor I publikut nëpërmjet medias

KSHH në bashkëpunim me Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (Soros) në kuadër të projektit “Çdo qytetar mund të kontribuojë për të ardhmen e vet”, ka përgatitur katër suplementeve të botuar në gazetën Korrieri.

Suplementi i parë është përqëndruar në garantimin ligjor të së drejtës kushtetuese të zgjedhësve, të drejtës së votës si edhe në përgjegjësinë që kanë personat e ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve sipas Kodit Pena. Gjithashtu, në këtë suplement janë përfshirë dy intervista të drejtuesve të organeve përgjegjëse shtetërore lidhur me hartimin e listave paraprake të zgjedhësve, debatet dhe vështirësitë në hartimin e tyre si edhe lidhur me shkeljen e afateve ligjore nga ana e partive politike për ngritjen e komisioneve zgjedhore.

Suplementi i dytë i është kushtuar të drejtës së studentëve për të votuar në vendqëndrimet e tyre dhe masat e ndërmarra nga rektorët e universiteteve dhe dekanët e fakulteteve për të garantuar këtë të drejtë. Për këtë qëllim janë kryer intervista të shumta me studentë dhe me rektorë të universiteteve në rrethe të ndryshme të vendit. **Suplementi i tretë** fokusohet në faktorët që pengojnë ngritjen në kohën e caktuar nga ligji të komisioneve zgjedhore, pasojat e dëmshme që mund të sjellin vonesa të tilla në realizimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe transparente. Gjithashtu, në këtë suplement trajtohet dhe çështja e krijimit të grupeve të numërimit të votave, detyrat e tyre dhe afati ligjor brenda së cilës duhet të paraqiten propozimet e partive politike për anëtarët e grupeve të numërimit të votave. Në **suplementin e katërt** trajtohet fillimi i fushatës zgjedhore, financimi i saj me transparencë, ankimmimet në rrugë administrative dhe gjyqësore. Gjithashtu, në një material të veçantë theksohet roli i vëzhguesve në vëzhgimin me transparencë dhe me objektivitet të procesit zgjedhor, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe për këtë qëllim është botuar një deklaratë e KSHH-së lidhur me kufizimin e të drejtës së vëzhgimit të vëzhguesve vendas në përputhje me ndryshimet e bëra Kodit Zgjedhor.

10.2 Rritja e aksesit të veprimtarisë së KSHH-së në media

Gjatë kësaj periudhe tre mujore KSHH ka patur një mbështetje dhe një pasyqrim të plotë në median e shkruar dhe atë elektronike. Gjithashtu ashtu siç është paraqitur dhe më sipër KSHH-ja ka përgatitur 4 suplemente me tematikë rreth procesit zgjedhor të cilat janë botuar në gazetën “Korrieri”, si dhe shumë shkrime dhe dhënie intervistash dhe opinionesh. Në fokus ka qënë kryesisht procesi zgjedhor.

10.3 Emisione në TV

10.3.1 Pjesëmarrje në programin e “Mirëmengjes” të Radio Televizionit Shqiptar, Tiranë, më 16 Prill 2005

Znj Vasilika Hysi ishte e ftuara e mengjezit në programin e përditshëm të RTSH. Në këtë program, u bë një paraqitje e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, misionit dhe rolit të tij në shoqërinë shqiptare. Krahas ekspozezë që iu bë veprimtarive të KSHH-së publiku u informua edhe shkeljet më të shpeshta të të drejtave të tyre dhe për mënyrën e adresimit të ankesave pranë këtij komiteti. Pjesë e bisedes ishin zgjedhjet parlamentare 2005 dhe sensibilizimi i votuesve për të parë listat e zgjedhësve dhe për të marrë pjesë në votime.

10.3.2 Pjesëmarrje në programin e Radio Tiranës, kanali 1 dhe 2 dhe të radio Tiranës në Satelit për shqiptarët jashtë Atdheut, Radio Tirana, Tiranë, më 17 prill 2005

Në kuadër të sensibilizimit të shtetasve për rolin e tyre në zgjedhjet parlamentare 2005, Radio Tirana organizoi një emision sensibilizues. Në të ishin të ftuar të merrnin pjesë përfaqësues të organizatave të ndryshme vëzhguese vendase. Komiteti shqiptar i Helsinkit u përfaqësua nga znj. Vasilika Hysi dhe z. Niazi Jaho. Në këtë emision, përfaqësues të KSHH-së trajtuan rolin e KSHH-së në këtë process, kontributin e KSHH-së në zgjedhjet e mëparshme si dhe veprimtaritë që kryen KSHH-ja në kuadër të zgjedhjeve parlamentare.

11. NGRITJE KAPACITETESH TË VETË ORGANIZATËS

11.1 Vizita studimore në Kroaci

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale të administratës së burgjeve, nga datat 24-29 Maj 2005, KSHH-ja organizoi një vizitë studimore në Kroaci¹¹. Pjesëmarrës në këtë vizitë studimore ishin përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, si edhe disa drejtues të sektorëve të sigurisë dhe të edukimit të disa burgjeve të Shqipërisë.

¹¹ Kjo vizitë studimore u realizua në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

Objektivi kryesor i vizitës në Kroaci ishte për të parë nga afër mënyrën sesi realizohej drejtimi i burgjeve në këtë shtet¹², sesi janë organizuar aspekte të veçanta që kanë të bëjnë me trajtimin psikosocial në kuadër të rehabilitimit dhe riintegrit të të dënuarve të tilla si programet e punësimit, të edukimit dhe të arsimimit të tyre të përgjithshëm dhe profesional.

Grupi pjesëmarrës vizitoi dy institucione riedukimi të tipit të mbyllur me regjim sigurie të lartë, një institucion gjysëm të hapur dhe një të tipit të hapur si edhe një institucion riedukimi për të mitur. Nga të gjitha vizitat e realizuara në burgje të ndryshme u evidentua fakti se një rëndësi shumë të madhe në rehabilitimin dhe në riintegrimin e të dënuarve i vihej respektimit të personalitetit dhe dinjitetit të të dënuarve si qenie njerëzore si dhe përcaktimi i një programi individual trajtimi për çdo të dënuar.

Kjo vizitë studimore ia arriti qëllimit duke bërë të mundur që stafi drejtues i DPB-së të fitojë një përvojë shumë të mirë në trajtimin e të dënuarve në punën e tyre të përditshme.

11.2 Trajnimi “Menaxhimi i projektit”

Gjatë periudhës 1-3 Qershor dy anëtare të stafit të KSHH-së morën pjesë në trajnimin e organizuar nga NET (Netëork for Exchange and training) me temë “Menaxhimi i Projektit”. Në këtë trajnim u trajtuan pika të rëndësishme të cilat përfshinin ciklin nga planifikimi deri në vlerësimin e një projekti. Ky trajnim bëhej në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit të KSHH-së, të cilën u trajnuan Klesta Alikaj, juriste/As.administrative, Etilda Saliu, juriste/As.projektesh.

11.3 Trajnimi “Marëdhëniet publike”

Gjatë periudhës Maj-Qershor 2005, Klesta Alikaj, juriste/As.administrative mori pjesë në një trajnim trejavor të organizuar nga Instituti Shqiptar i Medias për marëdhëniet me publikun. Qëllimi i këtij trajnimi ishte dhënia e udhëzimeve teorike dhe praktike për forcimin i marrëdhënieve me Publikun në një organizatë apo institucion.

¹² Duhet patur parasysh se Kroacia ka një histori zhvillimi të organizimit shtetëror të ngjashme me Shqipërinë

12. ANEKS NR.1 - DEKLARATA

NUK U RESPEKTUA AFATI LIGJOR I SHPALLJES SË LISTAVE ZGJEDHORE

Tiranë, më 5 Prill 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) çështjen e shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve dhe ndryshimet në to i konsideron një nga aspektet më të rëndësishme të procesit zgjedhor. Në kuadër të misionit të vet, KSHH-ja ndërmori një vëzhgim të pjesshëm lidhur me shpalljen e listave të zgjedhësve. Nga vëzhgimet e kryera në qytetet **Tiranë, Korçë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Kukës dhe Fier rezultoi se:**

- 1 **Deri në datën 4 Prill 2005, përveç rrethit të Fierit dhe pjesërisht të Tiranës, listat paraprake të zgjedhësve nuk rezultojnë të jenë shpallur.**
- 2 Në disa qendra votimi janë shpallur listat e zgjedhësve, por ato **nuk janë vendosur në vende të dukshme dhe të mundshme** për t'u kqyrur lirisht dhe në çdo kohë nga zgjedhësit.

Nga sa përmendëm më lart, **KSHH-ja konstaton se** në rastin konkret **është shkelur pika 2 e nenit 64/2 të Kodit Zgjedhor** ku thuhet se “Procesi i përgatitjes së listës së zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2005 fillon jo më vonë se data 15 Mars 2005 ...” ndërsa “lista paraprake shpallet jo më vonë se data 31 Mars 2005”.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit mendon se vonesa e mësipërme dhe çdo vonesë tjetër në këtë drejtim mund të shoqërohet me pasoja të dëmshme për këto arsye:

- 1 **Së pari**, shpallja me vonesë e listave paraprake të zgjedhësve shkurton afatin e njohjes së zgjedhësve me këto lista.
- 2 **Së dyti**, veç kësaj, shkurtohet afati i përcaktuar në pikën 1 të nenit 56 të Kodit Zgjedhor ku thuhet se “Brenda 30 ditëve nga shpallja e listave paraprake të zgjedhësve, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës ...”. Kjo do të thotë se kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore pa shpalljen e listave paraprake nuk mund të fillojnë lajmërimin me shkrim të zgjedhësve, siç parashikon dispozita e mësipërme.

Në këto kushte, **Komiteti Shqiptar i Helsinkit e shikon të nevojshme t'i bëjë thirrje të gjithë kryetarëve të njësisë të qeverisjeve vendore që të marrin masa urgjente për shpalljen e listave paraprake të zgjedhësve dhe i sugjeron Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit që të ushtrojë kontroll për të mos lejuar zvarritje në këtë proces.**

T'I JEPET FUND VAZHDIMIT TË MBAJTJES NË PARABURGIM TË PERSONAVE TË DËNUAR ME VENDIM TË FORMËS SË PRERË TË GJYKATËS

Tiranë, më 13 Prill 2005

Korrespondenti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit na njofton se para dy ditësh në **ambjentet e Komisarariatit të Elbasanit ka nisur një protestë nga një pjesë e personave që mbahen në**

dhomat e paraburgimit të këtij komisariati. Ata janë kryesisht të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Sipas korrespondentit tonë, ata kërkojnë transferimin e tyre në institucionet e vuajtjes së dënimit. Sipas verifikimeve në vend dhe bisedave me Drejtorin e Policisë së Qarkut, shefin e rendit, përgjegjës të dhomave të paraburgimit ka rezultuar se në Komisaratin e Policisë së Elbasanit megjithëse **kapaciteti është llogaritur për 45 persona në fakt ndodhen 80 persona**. Kjo e vështirëson gjendjen aq më tepër tani që fillon koha e nxehtë. Gjatë vëzhgimit rezultoi se midis 80 personave, **16 janë të dënuar me vendim të formës së prerë**.

Drejtoria e Qarkut Elbasan i është drejtuar me dy shkresa Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me kërkesën për transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit e ka ngritur disa herë nevojën urgjente që të gjithë të dënuarit me vendim të formës së prerë të transferohen në institucionet e vuajtjes së dënimit, por siç duket megjithë masat e marra çështja e mësipërme mbetet problematike. Është kjo arsyeja, që KSHH e shikon të nevojshme që për këtë problem t'i drejtohet edhe një herë Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Për të gjithë është e qartë se mbajtja në gjendje paraburgimi e të dënuarve me vendim të formës së prerë të gjykatës përbën shkelje të ligjit që mund të shoqërohet me shqetësime dhe pasoja të dëmshme.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me këtë rast i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë që për efekte transparente ta marrë në shqyrtim çështjen e mësipërme duke përcaktuar afatet përkatëse që do t'i jepnin zgjidhje kësaj gjendjeje.

NJOFTIM PËR SHTYP Tiranë më 14.04.2005

Në datën 14 Prill 2005, në ambjentet e Hotel Rognerit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një tryezë pune për "Respektimin e të drejtave të personave të paraburgosur - disa çështje të ligjit dhe praktikës". Të ftuar në këtë tryezë ishin përfaqësues të lartë të Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, drejtues të institucioneve të paraburgimit të vëzhguara nga KSHH-ja si edhe vëzhgues të KSHH-së. Qëllimi i kësaj tryeze ishte adresimi i disa problemeve të dala nga zbatimi i Rregullores Nr. 1075, datë 15.09.1999 të Ministrisë së Rendit "Për sigurimin e trajtimit të paraburgosurve", probleme të cilat janë vënë re gjatë vëzhgimeve të vazhdueshme të ndërmarra nga KSHH.

Gjithashtu, Komiteti Shqiptar i Helsinkit me anë të kësaj tryeze tërhoqi edhe një herë vëmendjen se Rregullorja Nr. 1075 e miratuar nga Ministria e Rendit vjen në kundërshtim me Ligjin Nr. 8328 datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimit të dënuarve me burgim". KSHH që nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje ka paraqitur zyrtarisht vërejtjet e tij në lidhje me këtë akt nënligjor, por fatkeqësisht këto nuk janë marrë parasysh nga autoritetet përkatëse shtetërore.

Folësit në këtë tryezë u ndalën në disa probleme konkrete të cilat kufizonin ose mohonin të drejtat e garantuara me ligj të personave të paraburgosur për shkak të zbatimit të kësaj Rregulloreje. Disa nga këto probleme i gjeni si më poshtë:

1. Përkeqësimi i kushteve higjieno-sanitare në dhomat e paraburgimit si rrjedhojë e orarit të kufizuar për të paraburgosur për të kryer nevojat e tyre personale.

2. Mungesa e dispozitave përkatëse që do të sigurojnë standartet e vendosura në ligj përsa i takon higjenes personale të paraburgosurve.
3. Mungesa e dispozitave në Rregullore lidhur me garantimin e cilësisë së ushqimit dhe kontrollit të tij.
4. Mungesa e dispozitave që garantojnë një shërbim shëndetësor 24 orë ashtu siç e parashikon Ligji Nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.
5. Ndalimi i çdo lloj literature informuese ose fetare në dhomat e paraburgimit. Kjo është një shkelje flagrante e dispozitës ligjore nenin 41 i Ligjit nr. 8328, datë 16.4.1988 “Mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.
6. Mungesa e dispozitave nënligjore lidhur me mundësimin e punës edukative në institucionet e paraburgimit.
7. Mungesa e rregullimeve nënligjore për të mundësuar një trajtim të veçantë për të paraburgosurit e mitur dhe ato gra.

Gjithashtu, përfaqësuesit e KSHH-së nga analiza që i bënë këtyre çështjeve theksuan se zbatimi i kësaj Rregulloreje është i papranueshëm, sidomos mbas miratimit të Rregullores Nr. 3750/2, datë 23.7.2003 të Ministrisë së Drejtësisë “Për organizimin e funksionimin e sistemit të paraburgimit”. KSHH mendon se, edhe pse në fakt shumica e vendeve të paraburgimit nuk i ka kaluar Ministrisë së Drejtësisë, ligjërisht ato i kanë kaluar asaj që në vitin 2001.

Në përfundim të tryezës KSHH-ja paraqiti rekomandimet e mëposhtme:

- a) Në të gjitha vendet e paraburgimit të zbatohet ligji Nr. 8328, datë 16. 4. 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” dhe Rregullorja e Ministrisë së Drejtësisë.
- b) Të shfuqizohet Rregullorja Nr. 1075, datë 15.9.1999 e Ministrisë së Rendit Publik
- c) Në të gjitha komisaritet e policisë ose në të gjitha vendet e paraburgimit të dërgohet Rregullorja e Ministrisë së Drejtësisë
- d) Të planifikohet njohja e Rregullores së Ministrisë së Drejtësisë nga të gjithë punonjësit që shërbejnë në vendet e paraburgimit
- e) Të paraburgosurit të njihen (duke përdorur format më të përshtatshme) me përmbajtjen e Rregullores së Ministrisë së Drejtësisë.

KSHH shpreson se organet përkatëse shtetërore do të marrin masat e duhura për të siguruar respektimin e të drejtave të personave të paraburgosur dhe një trajtim i tyre në përputhje me ligjin Nr. 8328, datë 16. 4. 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Kjo tryezë zhvillohet në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

DEKLARATË PËR SHTYP

TË RESPEKTOHET LIRIA E MEDIAS

Tiranë, më 11 Maj 2005

Më 8 maj 2005, policia bashkiake e rrethit Korçë, ka kryer një bllokim të aktivitetit të një lokali privat të qytetit të Korçës. Dy gazetarë dhe dy operatorë të televizioneve lokale të Korçës ishin duke filmuar veprimet e Policisë Bashkiake. Z.Ardian Shehu, kreu i policisë bashkiake të rrethit Korçë nuk ka lejuar filmimin e veprimeve të policisë Bashkiake, madje ka përdorur dhunë

ndaj znj. Juliana Dhimitri, e cila është edhe korrespondente e televizionit Top Channel dhe i ka hedhur njërit nga operatorëve kameran nga dora.

Komiteti Shqiptar të Helsinkit, nëpërmjet korrespondentes së tij në këtë qytet kontaktoi me gazetarët ndaj të cilëve ishte përdorur dhunë si dhe tentoi të kontaktonte disa herë me kreun e policisë bashkiake, z. Ardian Shehu, por nuk kishte mundur.

Duke marrë shkas nga fakti se ushtrimi i dhunës psikologjike ose fizike nga përfaqësues të autoriteteve shtetërore kundrejt gazetarëve nuk është rasti i parë, KSHH-ja dënon dhunën e ushtruar ndaj përfaqësuesve të Medias së shkruar dhe asaj elektronike.

Moslejimi i medias së shkruar dhe asaj elektronike për të marrë informacion dhe si rrjedhim për t'ia transmetuar atë publikut të gjerë përfshirë këtu edhe aktivitetet e ndryshme shtetërore, politike dhe shoqërore, është i papranueshëm në një shoqëri demokratike dhe pluraliste. Qëndrime të tilla kanë në vetvehte elementë censurimi dhe diskriminimi. Ato janë shkelje flagrante e së drejtës së informimit dhe lirisë së medias.

ZGJEDHJE TË LIRA DHE TË NDRERSHME KUR KA VULLNET POLITIK DHE ZBATIM TË LIGJIT

Tiranë, më 18 Maj 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) mëse një herë ka shprehur publikisht shqetësimin e vet për mosngritjen në kohë të Komisioneve të Zonave Zgjedhore (KZZ-ve) dhe për pasojat që mund të vinin për shkak të kësaj vonese. **Sipas pikës 4 të nenit 34 të Kodit Zgjedhor**, KZZ-të duhet të ishin ngritur **jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, d.m.th.** jo më vonë se data 3 Mars 2005.

Sipas njoftimeve të KQZ-së, megjithëse kanë kaluar 75 ditë nga afati i mësipërm **ato janë ngritur vetëm pjesërisht**, madje edhe në mbledhjen e parë të tyre u vërtetuan mungesa të theksuara.

KSHH mendon se për këtë zvarritje janë përgjegjëse partitë përkatëse politike që kanë të drejtën e propozimeve për paraqitjen e anëtarëve që do të formonin KZZ-të.

KSHH i sugjeron KQZ-së të mos qëndrojë në pritmëri të propozimeve, por të zbatojë pikën 6 të nenit 34 të Kodit Zgjedhor ku thuhet se: ***“Nëse partitë politike të shumicës parlamentare dhe të opozitës parlamentare që kanë të drejtë të paraqesin kandidatura për KZZ-të nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në afatin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kjo e drejtë u kalon automatikisht partive që vijnë në radhë me numër votash në Kuvend pas të parave, brenda grupimit përkatës. Kur kjo nuk është e mundur, propozimet bëhen sipas pikës 2 të këtij neni”.***

KSHH rithekson edhe një herë shqetësimin e vet se veprimtaria e KZZ-ve është e një rëndësie të veçantë. Si rrjedhim trajnimi i tyre i vonuar, formal dhe jo cilësor mund të ndikojë negativisht në kryerjen e detyrave të tyre të përcaktuar në ligj.

KSHH shpreh bindjen se mundësitë për zgjedhje të lira, të ndershme dhe të pakontestueshme ekzistojnë, por për këtë është i nevojshëm vullneti politik dhe zbatimi rigoroz i dispozitave të Kodit zgjedhor. Zbatimi i Kodit Zgjedhor është i detyrueshëm edhe për subjektet zgjedhore.

Mosrespektimi i afateve ligjore mund të çenojë standartet zgjedhore

Tiranë më 25 Maj 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, konstaton me keqardhje dhe shqetësim se **ngritja me vonesë të theksuar dhe të pajustificueshme të KZZ-ve**, si edhe fakti se **18 KZZ ende nuk janë konstituar**, vënë në dyshim ecurinë normale të proceseve të mëvonshme zgjedhore.

Edhe **një javë na ndan nga afati kur kandidatët për deputetë** duhet të paraqitin në KZZ-së dokumentacionin përkatës për rregjistrimin e tyre.

Paraqitja dhe shqyrtimi i këtij dokumentacioni në **kushtet e mostrajimit ose të një trajnimit formal dhe jo cilësor të KZZ-ve, mund ta zvarriste dhe kompromentonte edhe këtë proces.**

KZZ-ja, sipas ligjit është e detyruar të verifikojë saktësinë e çdo të dhëne që duhet të përmbajë ky dokumentacion dhe ti kthejë ato për plotësim në rastet kur kanë mangësi.

KSHH në këtë drejtim ka parasysh edhe përmbajtjen e nenit 80 të kodit zgjedhor ku thuhet se: Kandidatët e partive politike për deputetët dhe kandidatët e pavarur që nuk zotërojnë mandate në kuvend, detyrohen që dokumentacionit të mësipërm ti bashkangjitin një listë me nënshkrimet e 300 zgjedhësve që banojnë në atë zonë dhe që emrat e tyre janë në listat paraprake të zgjedhësve të asaj zone.

KSHH mendon se KZZ-të duhet të verifikojnë saktësinë e këtyre të dhënave dhe të mos justifikohen me arsyetimet “nuk premtan koha”, “jemi vonë”, etj.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për **partitë joparlamentare** që janë rregjistruar si subjekte zgjedhore në KQZ dhe që në këtë rast **janë të detyruara të paraqesin një listë kandidatësh për 40 vende në Kuvend**. Kjo listë duhet të mbështetet nga firmat e 7000 votuesve të rregjistruar në listat paraprake të zgjedhësve.

KSHH e shikon të nevojshme që lidhur me këtë çështje t'i referohet asaj pjese të Kodit të etikës së mirë për zgjedhjet, miratuar nga Komisioni i Venecias ku thuhet se: **“Procedura e verifikimi të firmave duhet të behet mbi bazën e rregullave të qarta, veçanërisht përsa i përket afateve dhe duhet zbatuar për të gjitha firmat”** (shih përkthim shqip faqe 17).

KSHH është i bindur se anëtarët e KZZ-së mund të përmbushin me sukses detyrat e tyre nëqoftëse ligjin e konsiderojnë autoritetin më të lartë, nëqoftëse ata trajnohen nëpërmjet testimit siç rekomandon edhe OSBE/ODIHR-I dhe Komisioni i Venecias, nëqoftëse në kryerjen e funksioneve të tyre tregohen të paanshëm dhe transparentë. Për këtë kërkohet edhe **mirëkuptimi i të gjithë subjekteve zgjedhore** si dhe **zbatimi nga ana e tyre i afateve dhe kërkesave që përcaktohen në Kodin zgjedhor.**

KSHH zbatimin **rigoroz të ligjit e konsideron element të rëndësishëm** që garanton arritjen e standarteve në zgjedhjet parlamentare apo lokale.

Në **3 qershor 2005 fillon zyrtarisht fushata zgjedhore**. Ka ende mundësi për të riparuar disa nga mungesat e vërtetuara. Po të ekzistojë vullneti politik, vështirësitë e mëtejshme mund të kapërcehen dhe zgjedhjet e 3 korrikut të këtij vitit, të tregojnë se edhe ne dimë të bëjmë zgjedhje të drejta, të ndershme dhe të pakontestuar.

Edhe njëherë për grupet e numërimit të votave

Tiranë, më 6 Qershor 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe disa organizata jofitimprurëse, menjëherë mbas miratimit të ndryshimeve që iu bënë Kodit Zgjedhor, **i drejtuan një letër Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë**, Z. Servet Pëllumbi. Në këtë letër, me argumenta, **sugjerohej nevoja për ndryshimin e nenit 95/2, pika 1, ku thuhet se KZZ-të grupet e numërimit të votave duhet t'i krijonin jo më vonë se 2 orë para mbylljes së votimit.**

KZZ-ja me ligj lejohet të krijojë deri në 5 grupe të numërimit të votave, pra si rrjedhim në të 100 zonat mund të krijohen deri në 500 grupe me 3500 anëtarë dhe 500 sekretarë. Duke patur parasysh, afërsisht këtë numër dhe detyrën e rëndësishme që ligji u ngarkon grupeve të numërimit të votave **KSHH shpreh mendimin se ngritja e grupeve të numërimit të votave 2 orë para mbylljes së votimit do të shkaktonte parregullsi të shumta.**

Kuvendi i Shqipërisë në përgjigje të letrës sonë nuk ndërmorri ndonjë nismë për ndryshimin e nenit 95/2 pika 1 e Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, **KSHH e pa të nevojshme që t'i drejtohej KQZ-së edhe pse ai kishte miratuar një udhëzim që detyronte KZZ-të të caktonin numrin e grupeve të numërimit të votave 5 ditë më parë dhe t'ia komunikonin këtë vendim partive politike përkatëse që kishin të drejtën e propozimeve.** Për KSHH-në ky afat nuk garanton, jo vetëm verifikimin e të dhënave për çdo anëtar që do të propozohet, por as edhe trajnimin cilësor të grupeve të numërimit të votave. Është kjo arsyeja që KSHH sugjeronte rishikimin e udhëzimit të KQZ-së dhe caktimin e afateve të tjera si për KZZ-të edhe për partitë politike. Por siç duket KQZ-ja nuk e pa të arsyeshme ta rishikonte udhëzimin e vet.

Para dy ditësh ne u njohëm me **raportin e Kryetarit të zyrës së OSBE-së në Tiranë Z. Vaçek**, paraqitur në Këshillin e Përbashkët të OSBE-së në Vjenë ku trajtoheshin edhe problemet e zgjedhjeve në Shqipëri. Na tërhoqi vëmendjen fakti se midis të tjerave ai **shprehte shqetësimin se ligji lejon** (është fjala për Kodin tonë Zgjedhor) **caktimin me vonesë të grupeve të numërimit të votave gjë që përbën pengesë të mundshme për një procedurë të shpejtë dhe korrekte** (shih gazetën "Albania", datë 4 Qershor 2005).

Pikërisht për kapërcimin e kësaj pengese, **KSHH që nga muaji shkurt i këtij viti dhe në vazhdim me letra dhe prononcime publike ka sugjeruar që ky problem të vlerësohet seriozisht dhe në interes të mbarëvajtjes së zgjedhjeve, të gjendeshin zgjidhje të shpejta dhe të përshtatshme.** Por deri më sot nuk dimë të jetë hedhur ndonjë hap ose të jetë përcaktuar ndonjë masë që do të parandalonte pasojat e mundshme dhe të dëmshme.

KSHH mendon se edhe në kushtet kur **nga zgjedhjet e 3 Korrikut na ndajnë vetëm 27 ditë, ekzistojnë mundësitë për ta kapërcyer edhe këtë vështirësi.** Për këtë është e nevojshme që **urgjentisht KZZ-të të vendosin numrin e grupeve të numërimit të votave që do të ngrihen dhe menjëherë këtë vendim t'ua bëjnë të njohur partive politike propozuese, ndërsa këto të fundit brenda pak ditëve të paraqitin në KZZ propozimet e tyre.**

KSHH mendon gjithashtu se po të veprohej në mënyrën e sipërpërmendur **do të krijoheshin mundësitë reale që të respektoheshin kërkesat ligjore lidhur me të dhënat që duhet të përmbushte personi që do të propozohet dhe caktohej anëtar dhe sekretar i këtij grupi.** Veç kesaj, kjo do të bënte të mundur edhe **trajnimin cilësor të anëtarëve të grupeve të numërimit, kusht i domosdoshëm për zbatimin në mënyrë korrekte të ligjit gjë që mund të ndihmonte edhe në respektimin e afatit ligjor për nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve nga KZZ-të.**

KSHH me këtë rast i drejtohet edhe një herë KQZ-së që në funksion të zbatimit të kompetencave të tij dhe në mënyrë të veçantë të zbatimit të nenit 153 të Kushtetutës të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që ky aspekt i rëndësishëm i zgjedhjeve të mos kompromentohet.

Zvarritje e pafalshme

Tiranë, më 13 Qershor 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) bashkohet me shqetësimin e shprehur nga Kryetari i KQZ-së, Z. Ilirjan Celibashi lidhur me vonesën e dhënies së informacionit përkatës nga kryetarët e njëjstëve të qeverisjes vendore për numrin e saktë të zgjedhësve në bazë zone dhe për çdo qendër votimi.

KSHH mendon se këtij shqetësimi mund t'i paraprinte Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Masat administrative ose penale që tani mund të merren ndaj shkelësve të ligjit, edhe pse të nevojshme, nuk janë kryesoret. KSHH mendon se kryesorja ishte parandalimi i shkeljes.

KSHH bashkohet gjithashtu me shqetësimin e KQZ-së se vonesa e mësipërme është e tillë që mund të kompromentojë një nga aspektet më të rëndësishme të zgjedhjeve, atë të votimit. **Prandaj, edhe kërkohet që ky problem të vlerësohet me seriozitetin e duhur.**

Të gjithë flasin, pranojnë dhe deklarojnë se zgjedhjet e këtij viti do të jenë një test për Shqipërinë, se ato duhet të përmbushin standardet e kërkuara.

KSHH edhe më parë ka theksuar se arritja e këtyre standardeve kushtëzohet nga dy faktorë: a) nga vullneti politik dhe b) nga zbatimi rigoroz i ligjit.

Nga zgjedhjet e 3 korrikut na ndajnë vetëm 20 ditë. Deri ditën e votimit ka çështje të rëndësishme që duhen zgjidhur, ka afate që duhen respektuar. Mjafton të përmendim një nga momentet më të rëndësishme: atë të ngritjes në kohë të grupeve të numërimit të votave sidhe trajnimin cilësor të anëtarëve të tyre.

*KSHH, me këtë rast u bën thirrje organeve përkatëse shtetërore, komisioneve zgjedhore dhe të gjithë subjekteve zgjedhore që të kontribuojnë në drejtim të zbatimit të ligjit dhe udhëzimeve të KQZ-së. **Procesi zgjedhor ka hyrë në fazën përfundimtare.** Le të vërtetojmë në praktikë, se edhe ne dimë të bëjmë zgjedhje të lira, të ndershme dhe të pakontestueshme.*

NJOFTIM PËR SHTYP

TIRANË, MË 14 QERSHOR 2005

Një nga detyrat kryesore të Komitetit Shqiptar të Helsinkit si një ndër organizatat e para joqeveritare (jofitimprurëse), ka qënë dhe mbetet monitorimi i zgjedhjeve periodike në vendin tonë. Në këtë drejtim KSHH si një organizatë me përvojë ka dhënë kontributin e tij modest për

zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të reformës zgjedhore në frymën e dokumentave ndërkombëtare.

KSHH i ndërgjegjshëm se zgjedhjet e 3 Korrikut të këtij viti për Kuvendin e Shqipërisë janë të një rëndësie të veçantë, ka vendosur të angazhohet në monitorimin e zgjedhjeve parlamentare të këtij viti. Një pjesë e mirë e vëzhguesve tanë kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të vëzhguar në mënyrë vullnetare.

KSHH ka marrë akreditimin për 113 vëzhgues afatgjatë dhe 7 vëzhgues afatshkurtër.

Në datën 14 Qershor 2005 u zhvillua trajnimin ligjor të vëzhguesve të KSHH-së.

Paraprakisht KSHH, ka përgatitur të gjitha materialet e nevojshme për t'ua shpërndarë vëzhguesve siç janë; zbërthimi i dispozitave më të rëndësishme të Kodit zgjedhor, njohja me udhëzimet e KQZ-së, pyetësore lidhur me informacionet që vëzhguesit do ti dërgojnë KSHH-së sipas aspekteve zgjedhore që do të vëzhgohen, etj.

Në këtë trajnim veç problemeve lidhur me njohjen e mirë të Kodit zgjedhor, në mënyrë të veçantë u fol për çështje lidhur me metodologjinë e vëzhgimit si dhe me detyrat dhe të drejtat e vëzhguesve.

Në këtë trajnim theksi u vu gjithashtu në qëndrimet dhe sjelljet e vëzhguesit me qëllim që të garantohet objektiviteti dhe paanshmëria. Nuk duhet të lejohet asnjë ndikim në vullnetin e zgjedhësve, asnjë dhunim në të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi. Vëzhguesi nuk do të jetë pasiv, por reagimet e tij do të jenë në përputhje me ligjin dhe në mënyrë të kulturuar, pa penguar veprimtarinë normale të komisioneve zgjedhore.

KSHH do të monitorojë disa çështje që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore, me caktimin e qëndrave të votimit, me ngritjen e KQV-ve dhe trajnimin e anëtarëve të tyre, ngritjen e grupeve të numërimit dhe trajnimin e tyre, etj.

Në mënyrë të veçantë, vëzhguesit e Komitetit Shqiptar i Helsinkit do të përqëndrojnë vëmendjen e tyre në monitorimin e procesit të votimit dhe të numërimit të votave.

KSHH do të shtrijë vëzhgimin e tij kryesisht në disa rrethe, Tiranë, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë dhe Elbasan, etj.

KSHH gjithashtu do të vëzhgojë procesin e votimit dhe në disa komisarate, paraburgime si dhe në disa burgje të sigurisë së ulët, të zakonshme dhe të lartë.

KSHH sipas rastit gjatë vëzhgimit mund të dalë me deklarata të veçanta të mbështetura në informacionet e vëzhguesve, ndërsa në përfundim të procesit do të shprehet mbi ecurinë e zgjedhjeve, zbatimin e dispozitave të Kodit zgjedhor kryesisht për ato aspekte të procesit zgjedhor, që do të vëzhgohen.

KSHH shpreson që edhe kontributi i vëzhguesve vendas të jetë në lartësinë e misionit të tyre dhe të shërbejë në arritjen e konkluzioneve të drejta dhe të bazuara.

Për KSHH-në vëzhgimi i këtyre zgjedhjeve do të jetë një element tjetër pozitiv në forcimin e rolit të vëzhguesve të kësaj organizate në Shqipëri dhe në drejtim të forcimit të tij dhe të përmirësimit të mëtejshëm të metodologjisë në fushën e monitorimit të zgjedhjeve.

Tiranë, më 15 Qershor 2005

Njoftim për shtyp

Më datë 14 Qershor 2005, në Strasburg u bë publik raporti i tretë i Komisionit evropian kundër racizmit dhe intolerancës (ECRI) për Shqipërinë. Raporti paraqet gjendjen e respektimit të rekomandimeve të ECRI-it deri në datën 17 dhjetor 2004 lidhur me të drejtat e minoriteteve dhe grupeve të tjera, të emigrantëve të huaj dhe azil kërkuesve si dhe disa probleme të veçanta që kanë të bëjnë me trajtimin e minoritetit rom, komunitetit të egjiptianëve, pjesëmarrjes së tyre në jetën publike, politike dhe në sektorë të tjerë.

Ky raport është rezultat analizash, bazuar mbi një numër të madh informacionesh nga burime të larmishme, të shkruara, kombëtare e ndërkombëtare. Vizita në vend e disa anëtarëve të ECRI-it bën të mundur takimin me qarqet drejtpërdrejt të interesuara (qeveritare dhe jo qeveritare) dhe mbledhjen e informacioneve të hollësishme. Dialogu konfidencial me autoritetet kombëtare u lejon këtyre të fundit të propozojnë, nëse eshohin të nevojshme, ndryshime në projekt-raport, për të korrigjuar gabime të mundshme faktike të përfshira në tekst. Në përfundim të këtij dialogu, autoritetet kombëtare mund të kërkojnë, nëse dëshirojnë, që mendimet e tyre të paraqiten si shtojcë e raportit përfundimtar të ECRI-t.

Në përmbledhjen e raportit të tretë të ECRI-it për Shqipërinë thuhet se « *që nga koha e botimit të raportit të dytë të ECRI-t për Shqipërinë më 3 prill 2001, janë shënuar përparime në mjaft fusha, që vihen në dukje në këtë raport. U përpunua një «Strategji kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve» për të zhdukur diskriminimin ndaj romëve në fusha të ndryshme të jetës. U krijua një komitet kombëtar i posaçëm për minoritetet, me qëllim që t'i paraqiten qeverisë rekomandime lidhur me zhvillimin e të drejtave të minoriteteve. Për më tepër, u vendos një procedurë shqyrtimi paraprak për të përcaktuar statusin e shtetasve të huaj që gjenden në Shqipëri në mënyrë të paligjshme dhe për të patur kujdes që viktimat e trafikut të qenieve njerëzore, azil-kërkuesit dhe personat që duan të riatdhesohen të trajtohen në mënyrën më të përshtatshme, sipas gjendjes në të cilën ndodhen. U miratua gjithashtu një strategji kombëtare e luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore. Nga ana tjetër, në të gjitha nivelet, policisë iu bë një formim i nevojshëm lidhur me të drejtat e njeriut »*

Krahas zhvillimeve pozitive, në këtë raport ECRI vë në dukje edhe disa probleme që nuk kanë gjetur zgjidhjen e duhur. Sipas tij « *shumë nga rekomandimet që parashtrohen në raportin e dytë të ECRI-t nuk janë zbatuar, ose janë zbatuar në mënyrë jo të plotë »*.

Në veçanti, ECRI është i shqetësuar për përfaqësimin e personave që i përkasin grupeve minoritare në jetën publike dhe për pjesëmarrjen e tyre në këtë të fundit; për gjendjen e romëve dhe të egjiptianëve që nuk ka shënuar përmirësime të dukshme; për numrin disproporcional të fëmijëve romë dhe egjiptianë si viktimat trafikimi, për regjistrimin kombëtar të popullsisë për të nxjerrë konkretisht të dhëna lidhur me përkatësinë kombëtare, etnike e fetare. Ai shtron gjithashtu një numër çështjesh përsa i përket kuadrit juridik për të luftuar diskriminimin e drejtë dhe të tërthortë, arsimimit në gjuhët minoritare dhe promovimit të vlerave kulturore, traditave dhe tolerancës, regjistrimit të romëve në gjendjen civile, problemit të strehimit, etj.

Në këtë raport, **ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare** të marrin masa të reja në disa fusha si :

- 1 Përmirësimi i pjesëmarrjes së anëtarëve të disa grupeve minoritare në organet vendimmarrëse dhe në proceset politike, në nivel kombëtar e lokal ;
- 2 Marrja e masave për të garantuar një integrim të plotë e tërësor të romëve dhe egjiptianëve në jetën shoqërore, ekonomike e politike, në të tëra nivelet ;
- 3 Përforcimi i masave për të luftuar trafikun e fëmijëve romë dhe egjiptianë.
- 4 Përkujdesja që romët të marrin pjesë sistematikisht në tërë drejtimit për zbatimin dhe vlerësimin e «Strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve» në nivel kombëtar e vendor dhe që egjiptianët të mos jenë objekt diskriminimi lidhur me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre në institucionet publike.
- 5 Hartimi i një Strategjie kombëtare të veçantë për përmirësimin e gjendjes së egjiptianëve në Shqipëri.
- 6 Mbledhja e të dhënave për të studjuar gjendjen e grupeve të ndryshme minoritare në vend.
- 7 Marrja e masave të reja për të shqyrtuar më nga afër ankesat lidhur me keqtrajtimet nga ana e policisë dhe për të garantuar pa ndërprerje të drejtat e azil-kërkuesve dhe personave emigrant të huaj që vijnë në Shqipëri.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit shpreh vlerësimin e vet për raportin e ECRI –it. Në përgjithësi, analiza e problemeve është objektive dhe shumëplanëshe. Rekomandimet e këtij organizimi janë të vlefshme dhe duhet të shërbejnë për vazhdimësinë e përpjekjeve të organeve shtetërore dhe të aktorëve të shoqërisë civile shqiptare në drejtim të përmbushjes së standartave ndërkombëtare lidhur me luftimin e shprehjeve të haoura dhe të tërthorta të intolerancës dhe racizimit në vend dhe në rajon.

KSHH-ja shpreh vlerësimin e vet për **masat e mara nga Qeveria shqiptare gjatë këtyre viteve në drejtim të përmirësimit të legjislacionit dhe praktikës së zbatimit të tij** lidhur me parandalimin dhe luftimin e formave të diskriminimit të hapur ose të fshehtë.

KSHH-ja vlerëson **përpjekjet e bëra nga shteti shqiptar, organizatat jofitimprurëse dhe organizmat e tjerë vendase dhe të huaja** lidhur me programet mbështetëse për grupet të veçanta të popullsisë. si: romët, egjiptianët, azil kërkuesit, etj. dhe për rritjen e kapaciteteve të specialistëve dhe vetë dhe vetë grupeve përfituese.

Por KSHH-ja në këtë ditë i bën apel **aktorëve të ndryshëm shtetërorë që të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të marra masa të mëtejshme lidhur me përmirësimin e respektimit të të drejtave të grupeve të veçanta të popullsisë, sidomos të romëve dhe të egjiptianëve, për zbatimin e strategjive të miratuara në fushën e reduktimit të varfërisë, të trafikimit të qënive njerëzore, të përmirësimit të kushteve të jetesës së komunitetit romë dhe egjiptianë.**

KSHH-ja **i bën thirrje organizatave, përfaqësuese të interesave të minoriteve dhe komuniteteve në Shqipëri të rrisin pjesëmarrjen e tyre në zbatimin e strategjive kombëtare dhe në monitorimin e tyre.**

Duke mbajtur parasysh rolin e medias së shkruar dhe elektronike, KSHH-ja i sygjeron asaj të **rrisë aksesin e pakicave kombëtare dhe grupeve të tjera te ajo,** të pasqyrojnë më me gjerësi kulturën, traditat dhe zakonet e minoriteve dhe komuniteteve të tjera dhe vlerat e tyre në shoqërinë shqiptare, si dhe të pasqyrojë më gjerë problemet që ato hasin në fusha të tilla si: pjesëmarrja në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Duke qënë periudhë parazgjedhore, **KSHH –ja i bën thirrje partive politike që në programet e tyre të përfshijnë masa mbështetëse konkrete për rritjen e pjesëmarrjes së përfaqësimit të pakicave kombëtare dhe komuniteteve të tjera në jetën politike,** ekonomike dhe sociale, të rrisin aksesin e grupeve të veçanta të shoqërisë, sidomos të të romëve dhe egjiptianë në aspekte të veçanta të procesit zgjedhor.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit **do të vazhdojë të kontribuojë në monitorimin e masave dhe të nismave që qeveria shqiptare do të ndër marrë në drejtim të përmirësimit të respektimit të të drejtave të minoriteve dhe komuniteteve në Shqipëri,** për parandalimin e diskriminimit, në çdo formë të shfaqjes së tij si dhe në drejtim të evidentimit më të mirë të vlerave dhe të harmonisë së pakicave dhe të komuniteteve në Shqipëri.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni:

Vasilika Hysi

Drejtoreshë Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Tiranë, Shqipëri
Anëtare e Komisionit evropian kundër racizmit dhe intolerancës (ECRI)

St: Gjin Bue Shpata, Pall 5/1, ap. 4

P.O box: 1752

Tel/fax: ++ 355 4 23 36 71

E-mail: office@ahc.org.al

Web site: www.ahc.org.al

dhe mund të vizitoni adresën:

Secretariat of ECRI

Directorate General of Human Rights – DG II
Council of Europe
F - 67075 STRASBOURG Cedex
Tel.: +33 (0) 3 88 41 29 64
Fax: +33 (0) 3 88 41 39 87
E-mail: combat.racism@coe.int
Web: www.coe.int/ecri

Dy fjalë për Komisionin evropian kundër racizmit dhe intolerancës (ECRI)

Komisioni evropian kundër racizmit dhe intolerancës (ECRI), ngritur nga Këshilli i Evropës, është një instancë e pavarur monitorimi në fushën e të drejtave të njeriut. I specializuar në çështje të luftës kundër racizmit dhe intolerancës, ai përbëhet nga anëtarë të pavarur e të paanshëm, që janë zgjedhur në bazë të autoritetit të tyre moral dhe të përvojës së tyre të njohur në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe intolerancën.

Një nga drejtimet e programit të veprimtarive të ECRI-t është analiza që ai bën vend për vend lidhur me gjendjen e racizmit dhe intolerancës në secilin nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, analizë që çon në parashtrimin e sugjerimeve dhe propozimeve për trajtimin e problemeve që ngrihen.

Tensionimi i situatës nuk i shërben standarteve që kërkohen

Tiranë më 20 Qershor 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit **ka përshëndetur angazhimin e forcave politike** që në procesin zgjedhor të 3 korrikut të këtij viti, **të respektojnë Kodin e etikës zgjedhore të pranuar nga të gjitha palët.**

KSHH mendon se kjo nismë është e nevojshme, sidomos në kushtet e vëndit tonë, ku polarizimi i tejskajshëm politik, herë pas here është shoqëruar me fenomene negative që veç të tjerave, deri në një farë mase ka cënuar dhe imazhin e Shqipërisë.

Kjo marrëveshje ishte gjithashtu e nevojshme edhe për faktin se këto zgjedhje do të tregojnë se sa të përgatitur jemi ne, për të ecur me hapa më të shpejta drejt integritimit në strukturave euroatlantike.

KSHH, konstatoi me kënaqësi se **fillimisht, fushata zgjedhore ishte relativisht e ekuilibruar**, sepse subjektet zgjedhore synuan kryesisht të shpalosin para zgjedhësve alternativat e tyre. E **njëjta gjë mund të thuhet edhe për disa debate televizive** të organizuara me kandidatë të pozitës dhe të opozitës.

Por KSHH me keqardhje vëren gjithashtu se me afrimin e datës të zgjedhjeve, disa **subjekte zgjedhore nuk kanë patur parasysh përmbajtjen e nenit 134 të Kodit zgjedhor** që nga një anë garanton **të drejtën për të bërë propagandë zgjedhore**, nga ana tjetër kërkon që ajo **të jetë e ligjshme**, pa folur pastaj **për normat e etikës zgjedhore**, që siç dihet janë elementë përbërës të kulturës demokratike.

Për KSHH-në është e qartë se fushata zgjedhore për vetë natyrën dhe synimet e saj është një garë që vështirë të zhvillohet si në vaj.

Megjithëkëtë, ne mendojmë se **gjuha e urrejtjes, fyerjet e personalizuara që prekin dinjitetin e njeriut si dhe akuzat e ndërsjellta ligjërish të pavërtetuara çenojnë frymën e ligjit dhe të kodit të etikës zgjedhore.**

KSHH pikërisht për këtë arsye i bën **thirrje subjekteve zgjedhore** dhe sidomos **dy partive më të mëdha** që në këto pak ditë që na ndajnë nga zgjedhjet e 3 korrikut, me sjelljet qëndrimet dhe deklaratat e tyre **të mos i japin shkas acarimit të atmosferës politike në vend sepse kjo nuk do të shërbente zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe të pakonstatuara.**

Zgjedhësit janë të vëmendshëm ndërsa partitë politike janë në provë.

Kur do të ngrihen Komisionet e qendrave (KQV-të)

Tiranë më 23.06.2005

Komiteti Shqiptar I Helsinkit, konstaton se krijimi me shumë vonesë i KZZ-ve, **nuk shërbeu si përvojë negative që anëtarët e KQV-ve të emëroheshin më parë, në afatet e përcaktuara në ligj.**

Sipas nenit 45 pika 2 të Kodit zgjedhor partitë politike përkatëse, **jo më vonë se 35 ditë para ditës së zgjedhjeve (domethënë brenda datës 30 Maj 2005)** duhet të paraqitnin në të 100 KZZ-të propozimet për antarë dhe sekretarë të KQV-ve.

Po të respektohej afati i mësipërm KQV-të, mund të ishin ngritur qysh në datën 5 qershor 2005. **E keqja është se KQV-të nuk do të ngrihen as në afatin e fundit ligjor që është 24 qershor 2005,** (shih nenin 45 pika 2 të Kodit zgjedhor).

Në **mbështetje të informacioneve të vëzhguesve të këtij komiteti dhe njoftimit të KQZ-së që paralajmëroi partitë politike të paraqitnin** sa më shpejt në KZZ propozimet për antarë të KQV-ve, **KSHH shpreh shqetësimin e vet,** sepse në vend që deri ditën e nesërme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë të ishin gritur KQV-të, **ky afat ligjor nuk u respektua për shkak se partitë politike ende nuk kanë paraqitur në të 100 KZZ-të propozimet e tyre.**

KSHH e sheh të nevojshme të theksojë se edhe sikur ditën e nesërme (24.06.2005) të përfundonin propozimet e partive, **KZZ-ve mund tu duheshin edhe 5 ditë të tjera për të verifikuar një e nga një të dhënat për çdo anëtar të propozuar** nëse ai përmbushte ose jo kërkesat e ligjit.

Po të ndodhte kjo i bie që KQV-të të ngrihen 5 ditë para ditës së zgjedhjeve.

KSHH pasojën e kësaj vonesa e shikon në pamundësinë e trajnimit të nevojshëm dhe cilësor të afro 38 mijë anëtarëve të KQV-ve.

Mendimi se në këto zgjedhje KQV-të nuk do të kenë ndonjë barrë të rënde sepse ato nuk do të angazhohen me numërimin e votave, pra si rrjedhim edhe trajnimi i tyre nuk do të jetë i vështirë, **është krejt i gabuar.**

Për **KSHH-në,** pavarësisht nga fakti i mësipërm, **KQV-të do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm.** Respektimi i dispozitave të Kodit zgjedhor gjatë procesit të votimit, **është përcaktues në vlerësimin e standarteve që kërkohen.**

KSHH ka ndjekur me vëmendje qëndrimet dhe reagimet e herë pas herëshme të KQZ-së. Ato ne i konsiderojmë pozitive sepse kanë synuar mbarëvajtjen në tërësi të aspekteve të ndryshme të procesit zgjedhor. Ky ishte edhe synimi i udhëzimit të KQZ-së, Nr. 15, datë 28.05.2005, "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të qëndrës së votimit".

KSHH, si një organizatë e angazhuar në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe e specializuar në monitorimin e zgjedhjeve periodike që janë zhvilluar në vendin tonë, nëpërmjet kësaj deklarate:

- a) **I bën thirrje partive politike** që të paraqitin me urgjencë propozimet për anëtarët e KQV-ve në të gjitha KZZ-të dhe
- b) **I sugjeron KZZ-ve** që menjëherë mbas paraqitjes të propozimeve, (pa dëmtuar cilësinë e verifikimit të të dhënave për çdo anëtar të KQV-së), të vendosin krijimin e KQV-ve. KSHH mendon se vetëm kështu mund të krijohet mundësia për një trajnim relativisht cilësor. **Vlen të përmendet se OSBE/ODIHR-i, vazhdimisht ka bërë vërejtje për trajnime të dobëta gjë që ka reflektuar në mos kryerjen si duhet të detyrave nga anëtarët e komisioneve zgjedhore.**

KUR DO TË NGRIHEN DHE KUR DO TË TRAJNOHEN GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE?!

Tiranë më 24 Qershor 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, edhe pse vetëm 9 ditë na ndajnë nga dita e votimit, e shikon të nevojshme të shprehë për herën e fundit **shqetësimin e vet** se nëqoftëse grupet e numërimit të votave do të ngrihen dy orë para mbylljes së votimeve, **trajnimi i 3200 – 4000 anëtarëve të tyre do të jetë i pamundur.**

Për KSHH-në, asgjë nuk i pengonte KZZ-të që fill pas ngritjes së tyre, **të caktonin numrin e grupeve të numërimit të votave dhe këtë vendim t'ua komunikonin partive politike që do të bënin propozimet përkatëse.**

Vendimet e KZZ-ve në këtë rast do të ishin në përputhje me nenin 95/2 pika 1 e Kodit Zgjedhor ku thuhet se: “Për numërimin e votave në rang njësie zgjedhore, me vendim të KZZ-së ... jo më vonë se 2 orë para mbylljes së votimit ... caktohen deri në 5 grupe numërimi me shtatë anëtarë dhe një sekretar secili”.

Veç kësaj, qysh në datën 23 mars 2005, KQZ-ja miratoi udhëzimin që detyronte KZZ-të që jo më vonë se 5 ditë nga data e votimit të caktonin numrin e grupeve të numërimit të votave dhe këtë vendim t'ua njoftonin menjëherë partive politike përkatëse.

Asgjë nuk i pengonte KZZ-të që këtë vendim ta merrnin të themi brenda muajit Maj ose në ditët e para të qershorit 2005.

KSHH mendon, se nuk ka asnjë justifikim që lidhur me nenin 95/2 pika 1 të Kodit zgjedhor dhe udhëzimit të KQZ-së të datës 23 Mars 2005, të zbatohen afatet e fundit duke vënë kështu në pikëpyetje trajnimin e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave.

KSHH siç dihet, që në fillim, ka parashtruar observacionet e tij lidhur me dispozitën e mësipërme të Kodit zgjedhor.

KSHH ka shprehur gjithashtu mendimin se edhe pse nga pikëpamja formalo – ligjore ngritja e grupeve të numërimit 2 orë para mbylljes të votimit nuk do të konsiderohej shkelje, zbatimi i këtij afati të fundit në mënyrë evidente do të përjashtonte mundësinë e trajnimit.

KSHH vazhdon ta quajë të gabuar dhe me pasoja mendimin se meqë sipas Kodit Zgjedhor, kontestimet që mund të vërtetoheshin gjatë procesit të numërimit të votave, do të zgjidheshin nga KZZ-ja, do të mjaftonte vetëm një trajnim, shumë i shpejtë i grupeve të numërimit (për të mos thënë se ky trajnim edhe mund të mos bëhej fare).

KSHH nuk mund të konceptojë këtë “justifikim” dhe do ta konsideronim me pasoja të dëmshme atë që mund të ndodhë: **trajnimin formal ose motrajnimin.**

KSHH ka parasysh se me procesin e rëndësishëm dhe delikat të numërimit të votave që kërkon aftësi, objektivitet, transparencë dhe operativitet, **ligji ngarkon vetëm grupet e numërimit të votave**, madje vlen të theksohet se janë ata që do të evidentojnë **cilat vota janë të vlefshme dhe cilat janë të pavlefshme, se janë ata që do të plotësojnë tabelën e rezultateve për çdo qendër votimi.**

KSHH mendon se të angazhosh në këtë proces (me vendim të KZZ-ve) persona të propozuar nga partitë politike, por që nuk njohin detyrat e tyre ligjore, do të thotë të tolerosh ose të pranosh ushtrimin e një detyre në mënyrë mekanike dhe të papërgjegjshme.

KSHH ka mendimin, se edhe në këto pak ditë që na ndajnë nga zgjedhjet e 3 korrikut, mund të reduktohen vështirësitë e mësipërme dhe të parandalohen pasojat e mundshme.

Pikërisht, për këtë arsye, **KSHH e shikon të nevojshme t’u sugjerojë KZZ-ve** që ende nuk kanë vendosur numrin e grupeve të numërimit si dhe partive politike që kanë të drejtën e propozimeve por që ende nuk i kanë paraqitur ato, **ta vlerësojmë seriozisht këtë problem.**

KSHH me këtë rast i sugjeron gjithashtu KQZ-së që në zbatim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore si dhe në kuadrin e mbikqyrjes dhe verifikimit të aspekteve të ndryshme të procesit zgjedhor, **ta ndjekë me përparësi këtë çështje me qëllim që qoftë edhe një apo dy ditë para zgjedhjeve të mundësoshet trajnimi i të gjithë anëtarëve të grupeve të numërimit të votave.**

ZGJEDHËSIT DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE KANË TË DREJTËN E ANKIMIT

Tiranë, më 27 Qershor 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), në bazë të informacioneve të vëzhguesve të tij, ka ndjekur me vëmendje faktin se një numër jo i vogël zgjedhësish nuk e kanë emrin e tyre në listat përfundimtare që janë shpallur.

KSHH e vlerëson seriozisht këtë çështje. Mangësitë në këtë drejtim **ndikojnë në ushtrimin ose jo të së drejtës së votimit-si një e drejtë themelore e shtetasve.**

Edhe pse 6 ditë na ndajnë nga dita e votimit, **KSHH i bën thirrje të gjithë zgjedhësve që nuk figurojnë në listat përfundimtare t’i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës me kërkesën për t’i lejuar ata që të votojnë në qendrën e tyre të votimit.** Zgjedhësit e mësipërm duhet ta kenë të qartë **se organi i vetëm kompetent për të vendosur lidhur me një çështje të tillë është gjykata përkatëse e rrethit.**

KSHH, nëpërmjet kësaj deklarate, **dëshiron të njoftojë dhe t’u bëjë të qartë zgjedhësve se** sipas nenit 60 të Kodit Zgjedhor ata **mund të paraqesin kërkesën** në gjykatë deri në 24 orë përpara datës së zgjedhjeve, d.m.th. **deri ditën e premtë datë 1 Korrik 2005, ora 24:00.** Zgjedhësit

gjithashtu, duhet të dinë se **gjykata mund t'i shqyrtojë këto çështje edhe ditën e fundit para zgjedhjeve**, madje edhe në ditën e zgjedhjeve **por jo më vonë se 6 orë përpara mbylljes së votimit**.

Zgjedhësit e kësaj kategorie duhet ta kenë të qartë gjithashtu se kjo procedurë do të jetë e thjeshtë dhe e shpejtë, mjafton që ata t'i bashkangjisin kërkesës edhe vërtetimet përkatëse.

Me vendimin që pranon kërkesën e tyre, zgjedhësit kanë të drejtë të shkojnë në qendrën e votimit dhe të votojnë si gjithë të tjerët, pavarësisht se në listën që ka KQV-ja nuk figuron emri i tyre.

KSHH, duke marrë shkas nga çështja e mësipërme, e shikon të nevojshme të trajtojë edhe të drejtën që kanë subjektet zgjedhore d.m.th. partitë politike, koalicionet partiake, kandidatët e tyre dhe kandidatët e pavarur për t'u ankuar sipas rastit në KQZ ose në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë në ato raste kur ata pretendojnë se u janë cënuar interesat e tyre të ligjshme.

I tillë ka qenë edhe qëndrimi i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, ku rekomandohej që subjektet zgjedhore kur mendojnë se u preken interesat e tyre kanë të drejtë të ankohen në instancat përkatëse të vendit dhe kur është rasti deri edhe në Gjykatën e Strasburgut.

KSHH e përmend këtë çështje meqë ndodhemi në prag të zgjedhjeve dhe shumë shpejt do të fillojnë ankesat drejtuar KQZ-së kundër vendimeve të KZZ-së si dhe ankesat drejtuar Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit kundër vendimeve të KQZ-së.

KSHH mendon se të gjithë por në rradhë të parë dy forcat më të mëdha politike, duhet të mësojnë edhe nga përvoja negative e zgjedhjeve të mëparshme ku nuk kanë munguar edhe presionet apo akuzat e natyrës politike ndaj institucioneve të tilla kushtetuese siç janë: Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, KQZ-ja dhe në ndonjë rast edhe ndaj Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiran që u krijua në vitin 2003.

Këto fenomene të padëshirueshme kanë ndodhur vetëm sepse ky apo ai vendim i dhënë prej organeve të mësipërme nuk i ka pëlqyer kësaj ose asaj force politike.

KSHH është i ndërgjegjshëm se të kontestosh ose të kritikosh një vendim gjyqësor është normale, por t'u bësh presion KQZ-së, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Kolegjit Zgjedhor, nuk është e pranueshme. Këto organe veprojnë në bazë të dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore, pavarësisht nga gabimet apo shkeljet e mundshme.

Për të parandaluar fenomene të tilla që mund të ndikojnë negativisht në acarimin e klimës politike në vend edhe në zgjedhjet e këtij viti, KSHH e shikon me vend t'i referohet nenit 145 të Kushtetutës ku thuhet se: ***“Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve” se “Ndërhyrja në veprimtarinë e Gjykatës ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit”.***

Të gjithë janë të detyruar të zbatojnë këtë dispozitë.

THIRRJE E KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT

Tiranë, më 29 Qershor 2005

Të nderuar zgjedhës,

Në 3 Korrik 2005 në vendin tonë zhvillohen zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë u garanton shtetasve të drejtën e zgjedhjes. **KSHH, organizata e parë jo-qeveritare misioni i së cilës ka qenë dhe mbetet mbrojtja e lirive dhe të drejtave të shtetasve**, duke patur parasysh se zgjedhjet periodike janë faktorë të rëndësishëm në drejtim të thellimit të mëtejshëm të reformave demokratike, i **bën thirrje të gjithë zgjedhësve që në 3 Korrik të këtij viti të ushtrojnë një nga të drejtat themelore, atë të votimit.**

Kjo është ngjarje e një rëndësie të veçantë. Për një periudhë 4 vjeçare, ne do të zgjedhim Kuvendin e ri të Shqipërisë, përfaqësuesit tanë më të lartë legjislativë.

Kjo është gjithashtu një ngjarje e rëndësishme edhe për faktin se Europa dhe SH.B.A. kërkojnë nga qeveria dhe klasa politike shqiptare **që zgjedhjet e këtij viti të jenë të lira, të ndershme dhe të pakontestuar.**

Pikërisht, për arsyet e mësipërme, Komiteti Shqiptar i Helsinkit u bën thirrje të gjithë zgjedhësve që të marrin pjesë në këto zgjedhje dhe të votojnë lirisht për subjektin zgjedhor që ata dëshirojnë.

Pjesëmarrja sa më e gjerë në votime do të tregojë pjekurinë e popullit tonë edhe për faktin se këto zgjedhje do të jenë një test për integrimin e Shqipërisë në strukturat euro-atlantike.

KSHH u bën thirrje edhe zgjedhëse që nuk figurojnë në listat përfundimtare, që t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të kërkojnë që ajo të marrë vendim për të lejuar që ata të votojnë në qendrën e tyre të votimit. **Mos ngurroni ta bëni këtë, ka ende kohë.**

Të nderuar zgjedhës!

Ligji ju garanton votën e lirë dhe të fshehtë. Denonconi rastet e premtimeve ose kanosjeve me synimin që ju të votoni pro ose kundër një kandidati ose subjekti zgjedhor.

Ruajeni fshehtësinë e votës suaj dhe mos lejoni futjen familjarisht në dhomën e fshehtë.

Në qoftë se nuk keni mundësi të votoni vetë, zgjidhni për t'ju ndihmuar një person tjetër, banor i qendrës suaj të votimit që ashtu sikurse ju, figuron në listën e zgjedhësve.

Tregoni kujdes në momentin kur votoni.

Që vota juaj të mos quhet e pavlefshme, vendoseni shenjën brenda kuadratit të caktuar.

KSHH uron me këtë rast të gjithë zgjedhësit, si edhe emigrantët që janë kthyer në vendin e tyre për të votuar, që nëpërmjet votës së lirë dhe të ndershme të kontribuojnë për një jetë më të mirë, për konsolidimin e demokracisë dhe institucioneve të saj në Shqipëri.